



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:093561  
Datë: 30.01.2024  
Numri i dokumentit: 05261596

A.nr.1316/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu, e me bashkëpunëtoren profesionale, Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditësit N.. N.. H. me adresë në rr. "B.." - B.-P.. të cilin me autorizim e përfaqëson R... R..jurist i diplomuar, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr. të dosjes 268 të datës 04.10.2019 dhe kërkesës për kompensimin e diferencës së pensioneve të papaguara, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 30.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit N.. N.. H. me adresë në rr. "B.." - B.-P.. të cilin me autorizim e përfaqëson R.. R..jurist i diplomuar.

II. ANULOHET vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me nr. të dosjes 268 të datës 04.10.2019, dhe paditësit i njihet e drejta në pensionin për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit parë, prej datës së nxjerrjes së ekspertizës mjekësore nga data 01.08.2022 e deri me datën 02.08.2027 për pesë vite në vlerën e pensionit prej 375€ (treqind e shtatëdhjetë e pesë Euro e zero cent) për çdo muaj.

III. DETYROHET e paditura Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve, me seli në Prishtinë, që paditësit t'i kompensoj në mënyrë retroaktive kompensimin, përkatësisht diferencën për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë, për periudhën kohore që nga data 01.05.2017, deri me datën 16.07.2023, kur paditësit i është njohur pensioni në grupin e parë, në shumë të përgjithshme prej 24,600.00€ (njëzet e katër mijë e treqind e

tetëdhjetë e katër euro e shtatëdhjetë e dy cent), dhe kamatën prej 8% sipas LMD-së në shumën prej 6,629.21€ (gjashtëmijë e gjashtëqind e njëzetë e nëntë euro e njëzetë e një cent), e gjithsejt shumën e përgjithshme prej 31,229.21€ (tridhjetë e njëmijë e dyqind e njëzetë e nëntë euro e njëzetë e një cent), krejt këto në afatin prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit me detyrim.

IV. UDHËZOHET paditësi që pas pesë viteve nga momenti i njohjes së kësaj të drejte, të paraqes kërkesë për rivlerësim mjekësor tek e paditura, për të vazhduar njohjen e kësaj të drejte.

V. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anulura dhe ka karakter detyrues.

VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

### A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, me prani të të autorizuarit të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi, me padinë e datës 07.08.2020, ka kërkuar nga gjykata që ti aprovohet si e bazuar kërkesëpadia. Ka kërkuar nga gjykata anulimin e këtij vendimi të të paditurës, pasi që sipas tij me nxjerrjen e këtij vendimi është bërë shkelje e dispozitave ligjore të nenit 8 par.1 dhe 2 të Ligjit me nr.05/L-067. Ka shtuar se arsyetimi është kontradiktor me vet ligjin ku decidivisht thuhet përfituesve të këtij u njihet e drejta për një kujdestar personal në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues. Paditësi konsideron po ashtu se vendimi është marr mbi bazën e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe në vështrim të LKA ai përmban të meta formale-juridike.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi *“ Kemi pranuar ekspertizën dhe plotësimin i saj të dt.25.09.2023, dhe nuk kemi vërejtje, kërkojmë të vazhdohet me procedurat më tutje. Në këtë fazë bëj precizimin e padisë ashtu që duke kërkuar anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi, kërkoj të detyrohet e paditura që paditësit në emër të diferencës së pensioneve të pa papaguare ti paguaj shumën 24,600.00€ kamatë vonesën ligjore 6,629.21€, gjithsejtë shumën totale prej 31,229.21 €”*.

Ndërsa në fjalën përfundimtare me parashtresën e dt.29.01.2024 deklaroi: *“Ashtu sikurse kemi theksuar në seancat e kaluara, qëndrojmë pranë padisë të ngritur në këtë gjykatë kundër vendimit të shkallës së dytë të ish MPMS, dhe tani MFPT-së me numër 268 të datës 22.03.2018, duke kërkuar që të aprovohet padia që nga data e paraqitjes së kërkesës (08.06.2017) deri me datën 01.05.2023, duke u bërë edhe llogaritja e diferencës, sipas ekspertizës financiare të datës*

06.07.2023 dhe plotësimi të ekspertizës të datës 25.09.2023 nga eksperte Emine Abdullahu. E theksoj datën 01.05.2023 për shkak se me këtë datë është marrë vendimi me të cilin është aprovuar kërkesa për rradhitjen në grupin e parë të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Duhet theksuar faktin se pala paditëse nuk ka bërë kërkesë mirëpo vendimi ka ardhur pa kërkesën e palës paditëse. Ndoshta padia e ushtruar në këtë gjykatë ka bërë që MFPT të reflektojë. Gjatë seancës kryesore është vërtetuar që paditësi N..H.. i ka plotësuar kushtet nga Neni 7, par.2 dhe neni 8 par.1 dhe 2 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik duke u radhitur në grupin e parë. Ekspertiza mjekësore e datës 01.08.2022 e bërë nga ekspertët mjekësor Dr Sh.. B..-R.etj , ku pas ekzaminimit është vërtetuar që paditësi N..H., bën pjesë në grupin e pacientëve paraplegjik dhe tetraplegjik në kategorinë e parë dhe gjithashtu theksohet që është e nevojshme përkujdesja nga ana e personit tjetër. Vendimi i kontestuar i shkallës së dytë përmban të meta që qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, përkatësisht nenit 47 që nënkupton se akti administrativ duhet të përmbajë përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ, gjë që nuk është bërë me rastin konkret. Vendimi i kundërshtuar i shkallës së dytë është juridikisht i paqartë dhe kundërrthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. E paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohej fakti se paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore për të fituar statusin e personave Tetraplegjik dhe Paraplegjik. Pra ne konsiderojmë që është shkelur ligji në dëm të paditësit. Nga të gjitha provat e administruara në këtë seancë gjyqësore, pa dyshim është vërtetuar kundërligjshmëria e vendimit të atakuar dhe bazueshmëria e kërkesë-padisë, prandaj kërkoj nga gjykata që vendimin e atakuar ta anuloj si të kundërligjshëm dhe të detyrohet e paditura të bëjë kompensimin e pensioneve të pa paguara. Prandaj, kërkojmë që të bëhet llogaritja e diferencës së pensionit në mes të grupit të dytë dhe grupit të parë që nga data 08.06.2017 deri me datën 01.05.2023, së bashku me pjesën e kamatëvonesës”.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 31.03.2022 , e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform dispozitave të nenit 3 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar, dhe nenit 9, paragrafit 5 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ajo në të cilën pretendon pala, se ky vendim është marrë me shkelje ligjore, nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në bazë të konstatimit të komisionit të mjekëve të

fushave përkatëse, të dokumentacionit mjekësor, dhe vlerësimit të komisionit mjekësorë të shkallës së dytë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me prova. Andaj, duke u bazuar në thëniet e cekura më lartë, e paditura i propozon gjykatës që pas administrimit të provave, të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N. H. nga P., duke lënë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: 10 fotografi, vendimi i dt.04.10.2019, Aktgjykimi A.nr.1399/18 dt.28.03.2019, raportet mjekësore të dt.21.01.1989, 18.06.2020, 22.10.2018, 17.05.2018, 15.06.2017, 27.05.2017, 30.05.2017, 11.05.2020,12.05.2020, 16.05.2020, 18.05.2020, 20,22,26, 28,30 05.2020, 02,04,06, 06.2020, 25.01.2021, 12.06.2020, 11.01.2021,12.09.2015, 22.01.2009, 14.02.2014, 06.02.2018, 17.05.2017, 16.06.2017, vendimi i dt.22.03.2018 dhe dt.11.12.2017, vërtetimi nga HENDIKOS i dt.18.07.2017, dhe libreza e HENDIKOS-it dt.29.09.2015, recetat për barna, kontrata për shoqërim të personit në nevojë e dt.21.6.2017, vlerësimi i komisionit vlerësues data nuk shihet mirë dhe shqyrtimi i ankesës dt.15.02.2018, ekspertiza mjekësore dt.04.08.2022, ankesa nr.175/23 dt.24.04.2023 nga Avokati i Popullit, ekspertiza dt.06.07.2023 dhe plotësimin e saj 25.09.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konflikte Administrative ashtu që vendosi meritorisht ta vendos këtë konflikt administrativ. Gjykata duke vlerësuar vendimin e goditur me padi, në përputhje me nenin 44 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thëniet e padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata gjeti se me aktgjykimin A.1399/2018 të datës 28.03.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, palës paditëse i është aprovuar kërkesës padia dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje të e paditura, ndërsa e paditura përsëri me vendimin kontestues të goditur me padi ka refuzuar të drejtën për njohën e këtij pensioni.

E paditura me vendimet e shkallës së dytë të MPMS-së, Departamenti i Pensioneve të datës 04.10.2019, të goditur me padi, prapë e refuzon ankesën e paditësit në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Nga vendimet e kontestuara, del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë: *“1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;*

*1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.*

Aktvendimet e kundërshtuar janë juridikisht të paqarta dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e tyre nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimeve të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimeve është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: *“Komisioni për ankesa sipas rekomandimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me nr. A.1399/2018 të datës 28.03.2019 në lidhje me padinë e paditësit z/znj N.. H... ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e dt.01.10.2019, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësorë që gjendet në lëndë dhe bazuar në vlerësimin e Komisioni mjekësor ka konstatuar se ankesa e ankuesit nuk është në harmoni me pikën 2 të nenit 7 dhe pikën 1 të nenit 8 të Ligjit 05/L-06, prandaj ankesën e refuzon si të pa bazuar”.* Në rastin konkret gjykata gjeti se, e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohet fakti se paditësit nuk i plotësojnë kriteret e parapara ligjore për të fituar statusin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm duke u thirrur në nenin 7 paragrafi 2 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Gjykata, në të mirë të konstatimit të gjendjes faktike, me aktvendimin A.nr.1316/20, të datës 16.05.2022, me propozimin e paditësit, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, e cila i është besuar Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (më tutje QKUK) në Prishtinë e cila me vendimin e dt.26.07.2022, ka caktuar ekspertet për kryerjen e kësaj ekspertize, mjekë specialist, Dr. Sh..B..-Neurologe etj.

Gjykata po ashtu, me qellim që të përcaktohet vlera e saktë e kompensimit të diferencës e cila duhet të paguhet prej datës 01.05.2017 deri me datën 01.07.2023, me kërkesën e palës paditëse me aktvendimin A.nr.1316/2020 të datës 15.06.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila i është besuar Ekspertes Financiare E.. A..

Të njëjtët, ekspertët mjekësor më datë 06.07.2023, kanë përpiluar Raportin e ekspertizës, gjykata po ashtu ka ftuar ekspertët mjekësorë të deklarohen lidhur me ekspertizën në seancën e shqyrtimit përgatitor, me ç’rast ekspertja mjekësore Dr. Sh.. B..-Neurologe, ka deklaruar se ne

kemi konstatuar se paditësi bën pjesë në grupin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik më grupin e parë, gjë e cila ishte konstatuar në mënyrë unanime edhe në ekspertizën mjekësore.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i'u referua Ligjit 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit 1 me të cilin është përcaktuar që *“Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”*, ndërsa neni 3 paragrafi 1, nën par. 1.1. , me të cilin është përcaktuar që *“Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme”*, ndërsa me nenin 8 paragrafi 1 të po të njëjtit ligj është përcaktuar që *“Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”*.

Ndërsa me Rregulloren nr.07/2017 Për Përbërjen, Funkcionin, Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenin 5 paragrafi 1 i saj janë përcaktuar Funkzioni dhe Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues ku është paraparë që *:1. Komisioni Vlerësues ka këto funksione dhe përgjegjësi: 1.1.Ekzaminimin e parashtruesit të kërkesës; 1.2. Vlerësimin e grupimit dhe nevojave sociale të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e cila bëhet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga Klinika e Neurologjisë-QKUK, si dhe ekzaminimit nga ana e Komisionit Vlerësues; 1.3. Përfituesit e grupit të parë janë persona me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së parandalimit të dekubituseve; 1.4. Përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve; 1.5. Përcaktimin e nevojës për edukim dhe arsimin; 1.6. Përcaktimin e nevojës për rehabilitim; 1.7. Përcaktimin e nevojës për kujdestar personal.”*

Ndërsa neni 9 i po kësaj rregulloreje ka paraparë procedurën e Rivlerësimit ku është përcaktuar që *“Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t'i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse*

*për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.*

Gjykata, pasi vlerësoi secilën provë veç e veç, dhe të gjitha në lidhshmëri me njëra-tjetrën, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Në veçanti, gjykata krijoi bindjen e saj nga ekspertiza e nxjerrë nga grupi i ekspertëve pranë QKUK-së, e datës 01.08.2022, dhe deklarimit të ekspertëve në seancën e shqyrtimit përgatitor, të datës 15.06.2023, të cilët kanë konstatuar se: pacienti N..H.. bën pjesë në grupin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik në kategorinë e parë për shkak të dobësisë të forcës muskulore në anësitë e poshtme si pasojë e lëndimit që ka pësuar si dhe rregullimit të sfinkterëve (inkontinencë urinare). Këto sëmundje kanë pasoja të përhershme dhe është e nevojshme përkujdesja nga personi i tretë.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar si provë dhe ia fali besimin vlerësimi të Komisionit mjekësorë të së paditurës, të cilët kanë konstatuar se nga vlerësimi i komisionit mjekësorë të së paditurës, të datës 16.06.2023, janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e së drejtës në kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë, prandaj duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht neni 7 paragrafi nën 2, gjykata kërkesëpadinë e tij e aprovoi si të bazuar, dhe si rrjedhojë e detyron të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, për faktin se paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshëm për njohjen e kësaj të drejte, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata kërkesëpadinë e tij e aprovoi si të bazuar, dhe si rrjedhojë e detyron të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë vlerësoi se sa i përket mendimeve dhe vlerësimi të ekspertëve, ekspertiza është e çartë, nuk ka kontradiktoritet në vete, si dhe e paditura nuk e ka kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave për seancën e shqyrtimit kryesor. Për të gjitha këto arsye, kjo gjykatë me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, respektivisht, në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga QKUK, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen. Lidhur me përcaktimin e lartësisë së shumës në kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe lidhur me realizimin e kësaj të drejte si në pikat e dispozitivit, gjykata i'u referua Ligjit nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht neni 7 paragrafi nën 9 të Rregullores nr.07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin,

Përgjegjësinë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të dhëna në përgjigje, se paditësi nuk i kanë plotësuar kriteret për njohjen e këtij pensioni, mirëpo, si të tilla, i refuzoi si të pabazuara, pasi nuk i pa me ndikim në një vendimmarrje tjetër nga vërtetimi dhe vendosja si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur konform nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe 65 të LKA-së dhe nenit 63 lidhur me nenin 21 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-006 LPK, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.1316/20, datë: 30.01.2024

G j y q t a r i

---

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.